



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.10, datë 26.05.2026



PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
PËR QËLLIME INDUSTRIALE, TË SUBJEKTIT "ELBESA" SH.P.K, ME
VENDNDODHJE: NJ. ADM BRADASHESH, BASHKIA ELBASAN.**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore", i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Shkumbin,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale, të subjektit "Elbesa" sh.p.k, me vendndodhje: Nj. Adm Bradashesh, Bashkia Elbasan.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (pus-shpimi):

- X= 502681.43
- Y= 4550847.34
- Z= 91 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 0.0578 \text{ l/sek}$



Qëllimi i përdorimit të ujit: Për qëllime industriale (për ftohjen e instrumenteve prerës gjatë prerjes së mermerit, granitit, etj.)

- Thellësia e pus-shpimit: 55 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : -44 m
- Koordinatat e gropës së dekantimit:

X= 502647.29;

Y= 4550876.24;

Z= 90 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBL SHKUMBIN

ILIR BEJTJA

